



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësia Org. Org. Jedrit. Org. Unit:	01	Kr. Prot. Sr. Prot. Prot. No:	412
Nr. i fazeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	27.04.2020
Myrëse		PRISHTINË/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve

Ministarstvo za Financije i Transfere / Ministry of Finance and Transfers

Nr. 4312020

Datë: 27.04.2020

Në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me qëllim të zbatimit të Vendimit Nr. 01/07 dhe 01/09 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID 19, Ministri i Financave dhe Transfereve merr këtë:

**VENDIM**

1. Zgjatet deri më 30 Qershor 2020 afati për pagesën e tatimeve si në vijim:

1.1. Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e mëdha individuale (IL);

1.2. Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale (IS);

1.3. Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për Korporatat e mëdha (QL); dhe

1.3. Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për Korporatat e Vogla.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij Vendimi, afati për deklarimin e tatimeve sipas pikës 1 të këtij vendimi mbetet deri me datën 30 prill 2020 dhe bëhet në pajtimit me legjislacionin tatimor në fuqi, si në vijim:

2.1. Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 4/L-102 dhe Nr. 04/L-223;

2.2. Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale;

2.3. Ligjit Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave; dhe

2.4. Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

3. Ky Vendim do të zbatohet për të gjithë tatimpaguesit të cilët në bazë të legjislacionit tatimor që janë të obliguar të deklarojnë dhe paguajnë për këto lloje tatimesh.

4. Tatimpaguesit të cilët janë në vështirësi financiare për shkak të pandemisë, mundën që të bëjnë kërkesë për marrëveshje të pagesës me këste, dhe bazuar në dëshmitë e prezantuara, Administrata Tatimore e Kosovës mund të mundësojë formën e tillë të pagesës për këto lloje të tatimit duke i rezervuar vetes të drejtën që pas përfundimit të masave në fuqi edhe të bëjë verifikimin e secilit rast.

5. Për të gjitha llojet e tjera të tatimeve afati për deklaram dhe pagesë përfundon me datën 30 Prill 2020 sipas Vendimit Nr. 26/2020 të datës 19.03.2020, të Ministrisë të Financave dhe Transfereve.

6. Obligohet Administrata Tatimore e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.



**Besnik Bislimi**

**Ministër i Financave dhe Transfereve**

Vendimi i dërgohet:

- ATK-së;
- Departamentit të Politikave Fiskale; dhe
- Arkivit të Ministrisë;